



Instituti i Kosovës për Drejtësi

Prishtinë, 29 nëntor 2013

Autorët: Betim Musliu dhe Adem Gashi

## RAPORT I SHKURTËR MBI PËRGGJIGJEN E ORGANEVE TË DREJTËSISË NDAJ VEPRAVE PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT #2

---

### GJETJET PRELIMINARE

Ky është raporti i dytë i shkurtër i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili ka monitoruar aktivitetet e institucioneve të drejtësisë në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit lidhur me procesin e zgjedhjeve të 3 nëntorit 2013. IKD vlerëson qasjen, standardin dhe angazhimin e organeve të sigurisë dhe ndjekjes në lidhje me veprimtarinë penale kundër të drejtave të votimit, gjithnjë duke krahasuar me hetimin dhe ndjekjen e krimeve në zgjedhjet e vitit 2010.

Një nga shqetësimet e mëdha është çështja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatësve dhe prokurorëve në këto raste. Shqetësimet ngriten pasi që një numër i prokurorëve kanë hequr dorë nga kërkesa e tyre fillestare për caktimin e masës për paraburgim, në anën tjetër një numër i gjykatësve kanë vendosur për masa më të buta se ato me paraburgim, dhe se një gjykatës ka shqiptuar dënim me kusht në instancën e parë për veprën penale “Kanosje të kandidatit”, që nuk është aspak në përputhje me dëmet e kësaj vepre.

#### Rekomandimet:

- Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës duhet të shtojnë bashkëpunimin dhe efikasitetin në zbatimin me përpikëri PSV-ve, duke zhvilluar hetime të detajuara siç obligohen me legjislacionin pozitiv dhe PSV në drejtim të sigurimit të elementeve të krimit të organizuar, duke ndjekur organizatorët e kryesve të krimeve të zgjedhjeve
- Prokurorët duhet të mbështesin mirë kërkesat e tyre për shqiptimin e masave për sigurimin e të pandehurit në procedurën penale, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Kërkesat e tyre për gjykatën nuk duhet të përpilohen me nguti, pa i analizuar mirë rrethanat dhe shkallën e dyshimit ndaj personave, të cilët duhet të sigurohen në procedurën penale
- Gjykatësit sugjerohen të kuptojnë shkallën e rrezikshmërisë, rëndësinë e zgjedhjeve dhe veprave penale kundër të drejtave të votimit dhe të shqiptojnë masa adekuate ndaj të pandehurve, për të siguruar mbarëvajtjen e procedurës penale, gjithnjë duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.
- Prokurori i Shtetit duhet të hetoj të gjitha veprimtaritë e tjera të dyshmita të ngritura vazhdimisht në opinion publik rreth mënyrës së financimit të partive politike dhe shpenzimeve të këtyre partive politikë, të cilat deklarohen se janë në shpërputhje me paratë e deklaruar.

- Duhet intensifikuar fushatën e PSH-së dhe PK-së që rastet të lajmërohen në kanale zyrtare, ku edhe do marrin përgjigje nga organet përkatëse

## GRUMBULLIMI I INFORMATAVE

IKD ka monitoruar përgjigjet e institucioneve të drejtësisë në lidhje me veprat penale kundër të drejtave të votimit qysh prej gushtit 2013 deri në publikimin e këtij raporti të dytë preliminar, që përfshijnë aktivitetet në organizimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional, përgjigjet e organeve të sigurisë dhe drejtësisë gjatë fushatës zgjedhore, gjatë ditës së votimit me 3 nëntor 2013, pas kësaj dite të votimit, ditën e rivotimit të mbajtur me 17 nëntor 2013 në tri Qendra të Votimit në Mitrovicën e Veriut, si dhe periudhën deri në publikimin e këtij raporti.

Duhet theksuar se përveç monitorimit, IKD në vazhdimësi ka përkrahur Koordinatorin Nacionalë për zgjedhjet 2013 nga Prokurori i Shtetit në përgatitje për të siguruar hetim dhe ndjekje efikase, përfshi thellimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen e standardit të hetimeve, thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, përmes senzibilizimit të opinionit në lidhje me format e bashkëpunimit për të parandaluar dhe luftuar kryesit e veprave penale kundër të drejtave të votimit.

## BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL

Bashkëpunimi ndër-institucional përveç që buron nga legjislacioni pozitiv në Kosovë, për zgjedhjet e 3 nëntorit u fuqizua me iniciativën e Kryeprokurorit të Shtetit, z. Ismet Kabashi, përmes nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Policisë së Kosovës, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. Progres i këtij bashkëpunimi të formalizuar përmes memorandumit, ishte krijimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit, të cilat sigurojnë saktësi të veprimeve për hetim dhe ndjekje penale të veprave penale kundër të drejtave të votimit, bazuar në mësimet e nxjerra nga e kaluara dhe përvojat më të mira të bazuara në ligj. Zbatimi i PSV-ve qysh prej ditës së parë të fushatës zgjedhore ka dhënë rezultatet e veta në fazën e hetimeve preliminare që ndërliken me veprat penale kundër të drejtave të votimit. Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2010, përgjigja e institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes në këto zgjedhje ka shënuar progres të madh, i cili për herë të parë është vlerësuar nga të gjithë mekanizmat vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Vlerësimet pozitive për këtë proces i kanë dhënë Misioni ndërkombëtar i ENEMO-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Rrjeti i organizatave jo-qeveritare Demokracia në Veprim, njëkohësisht, përfaqësuesit e misioneve diplomatike të vendeve të ndryshme në Prishtinë si dhe Bashkimit Evropian kanë vlerësuar se Kosova është e aftë të mbajë zgjedhje të lira dhe fer, dhe se qytetarët duke raportuar raste tek organet e drejtësisë kanë treguar përkushtimin e tyre për zgjedhje të lira dhe transparente si dhe besimin tek organet e ndjekjes. Shih Musliu B., Gashi A., *Raport i shkurtër mbi përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj veprave penale kundër të drejtave të votimit #1* (Prishtinë: IKD, 8 nëntor 2013), f. 5 dhe 6.

## HETIMET

IKD vlerëson qasjen proaktive të institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes në Kosovës, për të hetuar dhe ndjekur kryesit e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Zbatimi i PSV-ve nga Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës ka ngritur efikasitetin e këtyre institucioneve në hetimet dhe ndjekjen e kryesve të krimeve të zgjedhjeve. Qysh prej ditës së parë të fushatës zgjedhore, zbatimi i PSV-ve ka treguar rezultate në përgjigje më adekuate të policisë dhe prokurorisë ndaj personave të dyshuar si kryes të krimeve të zgjedhjeve. Risitë në PSV kanë ngritur përgjegjshmërinë e të gjithë personave, personave përgjegjës dhe personave zyrtarë rreth deklarimeve publike për kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit. Si asnjëherë më parë, secili veprim i denoncuar apo raportuar zyrtarisht në institucionet e drejtësisë është trajtuar me prioritet, gjë që shënon një progres, bazuar në përvojat e kaluara të zgjedhjeve të kaluara. Poashtu, reagimet e këtyre institucioneve, duke u bazuar në zbatimin e PSV-ve kanë barazuar para ligjit të gjithë edhe personat zyrtarë edhe politikanët, të cilët publikisht kanë deklaruar për vjedhje apo manipulim të votave, duke i marrë në pyetje, në secilin rast, praktikë kjo që nuk ka ndodhur asnjëherë më parë në këtë shkallë.

Prej fillimit të fushatës zgjedhore me 3 tetor deri më datën 26 nëntor 2013, Prokurori i Shtetit ka hapur 36 raste të hetimeve penale, kundër 72 personave, të cilët hetohen për kryerjen e 9 veprave penale kundër të drejtave të votimit, nga gjithsej 11 vepra sa përmban ky kapitull i Kodit Penal të Kosovës.<sup>2</sup> Prej këtyre rasteve, janë arrestuar apo ndaluar 33 persona. Prej fillimit të fushatës deri me datën 26 nëntor në të gjitha rastet, Prokuroritë Themelore kanë arritur të ngrisin 16 aktakuza, kundër 26 personave.

IKD shpreh shqetësim rreth disa rasteve të publikuara në media, për të cilat shfaqen elemente të veprës penale të kanosjes së kandidatëve dhe personave të caktuar të përfshirë me procesin e zgjedhjeve të 3 nëntorit. Pavarësisht se në këto raste Prokurori i Shtetit ka autorizuar policinë në zhvillimin e hetimeve preliminare, përkatësisht në grumbullimin e informacioneve, IKD vlerëson se këto raste duhet të trajtohen me seriozitet të madh, duke pasur parasysh tensionet e ngritura në fazën e dytë të votimit për balotazh, në të cilat partitë politike dhe militantët e tyre, kanë ashpërsuar gjuhën dhe veprimet e tyre nëse nuk parandalohen si duhet nga institucionet e drejtësisë, mund të ketë pasoja serioze. IKD ka monitoruar poashtu edhe shumë raste të tjera, në të cilat janë ndërmarr aktivitete dhe veprime të policisë dhe prokurorisë në drejtim të zbatimit të PSV-ve, të gjitha këto në kuadër të hetimeve preliminare, në të cilat raste IKD pret që këto institucione të dalin me rezultate përfundimtare për të zbardhur tentimet dhe krimet eventuale të kryera në kuadër të veprave penale kundër të drejtave të votimit.

## MASAT E FSHEHTA

Hap pozitiv që duhet theksuar për institucionet e drejtësisë, përkatësisht sigurisë është përfshirja e policëve civil për të gjurmuar më lehtë mundësinë e përfshirjes së personave në keqpërdorimin e zgjedhjeve, përfshirje kjo që në raste të caktuara ka siguruar informacione të mjaftueshme për të vepruar më drejtë në përputhje me dispozitat ligjore në ndjekjen e kryesve të veprave penale. Ky është një hap që këto institucione të drejtësisë duhet ta vazhdojnë dhe zhvillojnë më tutje për vazhdim të këtij procesi të zgjedhjeve edhe në ditën e votimit për balotazh në 25 komuna.

---

<sup>2</sup> Kodi Penal, Kapitulli XVIII, “Veprat penale kundër të drejtave të votimit”, 11 veprat penale (nenet 210-220).

## NDJEKJA PËR KRIM TË ORGANIZUAR

Prokurori i Shtetit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës për herë të parë kanë pranuar se kanë rast, në të cilin janë duke zhvilluar hetime për disa persona të cilët dyshohen për kryerjen e veprave penale nga kapitulli kundër të drejtave të votimit dhe gjatë zhvillimit të hetimeve do të ndiqen edhe elementet e krimit të organizuar dhe nëse gjenden, atëherë prokurorët ndjekjen do ta bëjnë edhe për krim të organizuar, por kjo mbetet të shihet në vazhdim të procesit të hetimeve.<sup>3</sup> IKD vlerëson se policia dhe prokuroria obligohen në përputhje me legjislacionin pozitiv dhe PSV që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të hetuar kontekstin e organizimit sesi është kryer secila prej veprave penale kundër të drejtave të votimit.<sup>4</sup> IKD shpreh shqetësimin në lidhje me financimin e partive politike dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatave, për të cilat vazhdimisht ka kërkuar hetime. Ky është një problem që vazhdon të mbetet i patrajtuar si duhet nga organet ndjekëse, ndërsa përditë raportohen në media shpenzimet e partive, të cilat nuk dihet se sa shpenzime janë bërë.<sup>5</sup> Prokurori i Shtetit nuk ka konfirmuar për IKD asgjë në këtë fazë, nëse ka hetime në këtë drejtim, në të cilën fazë thonë se prokurorët janë duke zhvilluar shumë hetime preliminar edhe hetime penale në kuadër të kapitullit për veprat penale kundër të drejtave të votimit, ndërsa këto vlerëson se janë çështje të brendshme për të cilat në momentin që do të ketë rezultate pohojnë se do të njoftojnë opinionin publik. IKD kërkon që të zbardhjen mënyrat e dyshimta të financimit të partive politike dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës, të cilat mund të jenë pistë e çmuar për zbulimin e veprimtarive të organizuara kriminale.

## PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE

IKD gjatë monitorimit të veprimeve ligjore të prokurorëve dhe gjykatësve në këto raste ka vërejtur lëshime nga të dyja palët sidomos në ditën e votimit me 3 nëntor 2013. IKD vlerëson qasjen e Prokurorit të Shtetit në trajtimin me prioritet të këtyre rasteve, duke ngritur aktet akuzuese ndaj personave të përfshirë në veprat penale kundër të drejtave të votimit, brenda një periudhe, e cila në rrethanat e Kosovës, mund të vlerësohet si kohë e arsyeshme dhe rekorde.

Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatësve dhe prokurorëve vazhdon të jetë shqetësim i madh, edhe pas reformave të thella në sistemin e drejtësisë. Prokuroritë dhe Gjykatat duket të mos jenë në nivelin e duhur profesional që të merren me raste të kësaj natyre, sidomos kur preken interesat e partive politike. Në një formë, vendimet e prokurorëve dhe gjykatësve janë plotësisht në suaza të ligjit, mirëpo, përkundër mundësive për masa më adekuate, vendimet e tyre janë duke prodhuar efekte, të cilat nuk përkujnë me qëllimet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial e as me luftimin serioz të krimeve të rënda për shoqërinë.

<sup>3</sup> Intervistë me Koordinatorin Nacionalë për zgjedhje nga Prokurori i Shtetit, znj. Laura Pula. 27 nëntor 2013.

<sup>4</sup> Shënim: Përveç që është detyrim ligjor bazuar në legjislacionin penal në Kosovë, ndërmarrja e këtyre veprimeve për të hetuar organizatorët e kryerjes së veprave penale kundër të drejtave të votimit është vendosur si standardi i parë në Procedurat Standarde të Veprimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit për zgjedhjet e 3 nëntorit 2013.

<sup>5</sup> "Partitë nuk e dinë sa kanë shpenzuar gjatë fushatës". Telegrafi.com. Publikuar me 18 nëntor 2013. (qasur për herë të fundit me 27 nëntor 2013 <http://www.telegrafi.com/lajme/partite-nuk-e-dine-sa-kane-shpenzuar-gjate-fushates-2-38148.html>)

Për 13 persona Prokuroritë Themelore kanë bërë kërkesa për caktim të paraburgimit, ndërsa nga Gjykatat Themelore kanë aprovuar paraburgimin vetëm ndaj 5 personave, ndërsa ndaj 5 personave të tjerë ka shqiptuar masën e arrestit shtëpiak dhe ndaj 3 të tjerëve masën e paraqitjes në stacion policor. Prokuroritë Themelore për 6 persona kanë kërkuar masën e arrestit shtëpiak, të cilën e kanë aprovuar gjykatësit. Këta të fundit kanë aprovuar edhe kërkesat e prokurorëve për masën e paraqitjes në polici për 5 persona ndërsa në procedurë të rregulltë janë lëshuar 48 persona.

Prokurorët e Shtetit kanë bërë ankesa në 4 raste ndaj vendimeve të gjykatave për mos caktim të masës së paraburgimit. Caktimi i masës së paraburgimit ndaj 4 personave nga Gjykata Themelore e Gjilanit është ndërruar me arrest shtëpiak nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, pas ankesave të bëra nga palët. 2 raste të hetimeve me 6 persona janë pushuar.

Duke u nisur nga çështja e kërkesave për paraburgim, IKD vëren dobësi të theksuara të sistemit. Në njërën anë, prokurorët brenda një kohe të shkurtër kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre për caktim të masës së paraburgimit. Shembull në rastin e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, prokurorët e saj në ditën e votimit me 3 nëntor kanë paraqitur në gjykatë 11 kërkesa për caktim të masës së paraburgimit ndaj 11 personave, ndërsa në seanca gjyqësore në 8 raste prokurorët kanë hequr dorë nga kërkesa e tyre për caktimin e paraburgimit, duke e ndërruar kërkesën për shqiptimin e masave tjera. Në anën tjetër, prokurorët megjithëse kishin paraqitur kërkesat për paraburgim, këto kërkesa nuk janë miratuar nga gjykatësit. Duke marrë parasysh rrezikshmërinë e lartë, pasojat e mëdha dhe ndërlidhjen e krimeve kundër të drejtave të votimit me një sërë krimesh tjera të korrupsionit të jakave të bardha, vendimet e prokurorëve dhe gjykatësve në këto raste duket të mos jenë në proporcion me dëmet. IKD vlerëson se kjo paraqet një dobësi të prokurorëve, të cilët nuk kanë qenë në gjendje të analizojnë si duhet dhe profesionalisht rastet e tyre në këtë fazë të procedurës penale për të shqiptuar masa adekuatë ndaj personave të dyshuar, për të siguruar prezencën e të pandehurve në procedurën penale. Sidomos, kjo paraqet shqetësim duke marrë parasysh faktin se fryma e ndërtimit të PSV-ve, parim i së cilave është arrestimi dhe ndalimi i të gjithë personave që përfshihen në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit.<sup>6</sup> Meqë prokurorët kujdestar kanë pasur në duar të tyre vetëm këto raste gjatë ditës së votimit, IKD konsideron se kanë pasur kohë të mjaftueshme për të analizuar mirë rastet e tyre dhe kërkesat për shqiptimin e masave të nevojshme për sigurimin e të pandehurve në procedurën penale. Pas paraqitjes së bazuar të kërkesës nga ana e prokurorëve, mbetet në vlerësimin e gjykatësit sesa janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masave të kërkuara nga prokurori.

Tanimë është e qartë se shqetësuese mund të jenë vendimet e gjykatave ku për vepra të rënda sikurse Kanosja e kandidatit është shqiptuar dënimi me kusht, një vendim tejet diskutabil. Në një aktgjykim të shpallur nga Gjykata Themelore e Gjilanit ndaj një personi të akuzuar në Gjilan për veprën penale nga neni 211 “Kanosja e kandidatit” nga kapitulli i veprave penale kundër të drejtave të votimit. Personi i akuzuar e ka pranuar fajësinë, ndërsa Gjykata ia ka shqiptuar dënimin prej 6 muajve me kusht për 1 vit. Në këtë rast Prokurori i Shtetit ka bërë ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës.

---

<sup>6</sup> Gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore për ditën e votimit me 3 nëntor 2013, IKD në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit kanë mbajtur shtatë tryeza me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve relevant të përfshirë në procesin e zgjedhjeve, në shtatë qendrat më të mëdha të Kosovës si në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë dhe Pejë. Në këto tryeza Koordinatorja Nacionale për zgjedhje nga Prokurori i Shtetit znj. Laura Pula bashkë me Koordinatorët e shtatë Prokurorive Themelore, përfshi dhe prokurorët kujdestar të zgjedhjeve kanë proklamuar parimin kryesor të PSV-ve, për arrestim/ndalimin e të gjithë personave që përfshihen në kryerjen e veprave penale kundër të drejtave të votimit.

IKD është kundër shqiptimit të masave të rënda pa pasur arsyeshmëri të mjaftueshme dhe sugjeron që të sigurohen gjykatësit se janë duke u respektuar të drejtat dhe liritë e personave, por vlerëson se ato duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, për të siguruar një proces të rregulltë dhe të drejtë ndaj të pandehurve, por njëkohësisht, duke dërguar mesazh tek të gjithë për qëllimin e shqiptimit të atyre masave.

## KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Sa i përket njoftimit të opinionit publik dhe transparencës rreth aktiviteteve të Policisë së Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit rreth rasteve që ndërlidhen me zgjedhjet, IKD vlerëson se ka pasur një rol të rëndësishëm të Prokurorit të Shtetit dhe Policisë së Kosovës, të cilat në koordinim të ngushtë dhe bashkërisht kanë njoftuar në perioda të rregullta rreth rrjedhës së këtyre lëndëve deri në ngritjen e akteve akuzuese përkitazi me veprat penale kundër të drejtave të votimit.

Njëjtë sikur në raportin e parë preliminar për zgjedhjet e 3 nëntorit, IKD thekson rëndësinë e raportimit të rasteve të keqpërdorimeve të zgjedhjeve në kanalet zyrtare, në mënyrë që të shkurtohet rruga dhe koha për tu përgjigjur sa më urgjent institucionet e sigurisë dhe ndjekjes. Raportimet në Prokurori të Shtetit dhe Polici të Kosovës mund të jenë të rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e ndonjë veprë të mundshme penale që ndërlidhen me të drejtat e votimit. Rrjedhimisht përmes sfidimit të këtyre institucioneve mund të arrihet edhe korrektimi në rastet e gabimeve apo dështimeve në hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale kundër të drejtave të votimit.

## RIVOTIMI NË MITROVICËN VERIORE

Rivotimi<sup>7</sup> me 17 nëntor 2013 në tri Qendra të Votimit në Mitrovicën e Veriut ishte mbajtur nën masa të rrepta të sigurisë nga Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i. Për dallim nga dita e votimit me 3 nëntor në Mitrovicën e Veriut, në të cilën u shënuan incidente serioze, duke shkatërruar disa kuti të votimit, në rivotim nuk u shënuan incidente serioze për ta prishur procesin e votimit, përkundër një atmosfere të tensionuar dhe nën masa të rrepta të sigurisë. Në atë pjesë, ka pasur të angazhuar pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe Prokuror kujdestar nga Prokurori i Shtetit së bashku me Prokuror kujdestar të EULEX-it. IKD ka përcjell përmes mediave aktivitetet në teren në ditën e rivotimit, ndërsa prej orës 07:00 të mëngjesit, deri në mbrëmje ka monitoruar Grupin Punues të Prokurorit të Shtetit, i cili është udhëhequr nga Koordinatorja Nacionale për zgjedhje, znj. Laura Pula. Në orën 06:30 minuta, Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit kanë larguar rreth 200 pjesëtarë të të ashtuquajturës “Mbrojtja Civile”, të cilët kishin qëndruar afër perimetrit të ndaluar të tri Qendrat e Votimit, në të cilat është mbajtur rivotimi.<sup>8</sup> IKD vlerëson se veprimet e Policisë dhe Prokurorit të Shtetit në këtë rast nuk kanë qenë në përputhje me veprimet e nevojshme ligjore. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton qartë se kush janë autoritetet që ofrojnë siguri në Republikën e Kosovës, ndërsa pjesëtarët e organizatës së ashtuquajtur “Mbrojtja Civile” në këtë rast kanë qenë strukturë paralele, pjesëtarët e të cilës është dashur të arrestohen. Kjo duhej të ndodhte nëse do të veprohej mbi bazën e parimit të sundimit të ligjit, duke

<sup>7</sup> Sipas rekomandimit të Qendrës për Numërim dhe Rezultate, më 5 nëntor 2013, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka anuluar tri Qendra të Votimit në Mitrovicën e Veriut. Shih <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/140>.

<sup>8</sup> “Policia e Kosovës ka larguar pjesëtarët e “Mbrojtjes Civile”. Radio Evropa e Lirë. Publikuar me 17 nëntor 2013. (qasur për herë të fundit me 27 nëntor 2013 <http://www.evropaelire.org/content/nees/25170725.html>)

respektuar rendin juridik dhe kushtetutes të Republikës së Kosovës, pa pasur nevojë për kalkulime politike në ndërmarrjen e veprimeve nga policia dhe prokurorët. IKD vlerëson se kjo është një dështim i institucioneve të sigurisë dhe ndjekjes, të cilat nuk kanë vepruar në përputhje me autorizimet ligjore, kundër personave, të cilët kanë luajtur rolin e ofruesit të sigurisë në ditën e rivotimit në tri Qendrat e Votimit në Mitrovicën e Veriut. Përveç këtij rasti, gjatë ditës që janë mbajtur rivotimet janë shënuar dy incidente të vogla, në të cilat policia me prokurorinë kanë arrestuar shkurtë disa persona, por të cilët janë liruar për shkak se nuk kanë gjetur dyshim për t'i mbajtur.

## PËRGATITJET PËR RAUNDIN E DYTË

Për përgatitjet për raundin e dytë, Prokurori i Shtetit është duke ndërmarrë disa veprime bazuar në mësimet e nxjerra. Prokurori i Shtetit ka njoftuar se në raundin e dytë, ku zgjedhjet do të mbahen në 25 komuna të Republikës së Kosovës, do të angazhohen 60 prokurorë kujdestar, që i bie 10 prokurorë më shumë se më 3 nëntor. Për dallim nga 3 nëntori, për ditën e votimit të balotazhit me 1 dhjetor, Prokurori i Shtetit ka vendosur në të gjitha komunat të dërgojë prokuror të niveleve më të larta, si nga Prokurori i Shtetit dhe Prokuroria e Apelit. Kjo do të bëhet për të shtuar efikasitetin, kontrollin dhe llogaridhënien e veprimeve të prokurorëve dhe policëve në të gjitha komunat ku do të zhvillohen votimet për balotazh. Grupi Punues në Prokurorin e Shtetit që udhëhiqet nga Koordinatorja Nacionale për zgjedhje nga Prokurori i Shtetit është paralajmëruar se do të jetë me staf të mjaftueshëm, për të siguruar mbarëvajtje dhe koordinim të duhur me të gjithë Koordinatorët Rajonal, përkatësisht Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore në shtatë qendrat e Kosovës. Është paralajmëruar mbajtja e konferencave të rregullta për media, përmes të cilave do të njoftohet opinioni publik për veprimet e policisë dhe prokurorisë në ditën e votimit për balotazh.

## RRETH PROJEKTIT ([www.kli-ks.org/zgjedhjet/](http://www.kli-ks.org/zgjedhjet/))

Instituti i Kosovës për Drejtësi, po zbaton projektin “Iniciativa për ngritje të efikasitetit të organeve të drejtësisë për proces zgjedhor të lirë, drejtë dhe demokratik”, i cili ka për qëllim që të forcojë kapacitetet dhe rrisë bashkëpunimin me organet e drejtësisë në luftimin e efektiv të çfarëdo lloj krimi që pengon procesin e lirë, të drejtë dhe të besueshëm zgjedhor në Kosovë. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Ky projekt udhëhiqet nga bashkë-autorët raporteve analitike të vetme vendore të cilat kanë trajtuar përgjigjen e organeve të drejtësisë ndaj krimeve të zgjedhjeve. IKD gjatë këtij projekti do të mbështesë organet e ndjekjes në trajnim dhe ofrim të këshillave rreth ndjekjes efikase të krimeve të zgjedhjeve, sensibilizimin e opinionit rreth krimeve të zgjedhjeve, mbikëqyrjen e përgjigjes së organeve të drejtësisë sa i përket krimeve të zgjedhjeve, si dhe përpilimin e raporteve të cilat japin rekomandime konkrete për të përmirësuar funksionimin e organeve të drejtësisë në të ardhmen.

Qëndrimet e shprehura në raport janë të autorëve, ato nuk janë domosdoshmërisht qëndrime të donatorit.

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD  
Rr. Rexhep Luci  
9 A / hyrja 1 / nr. 5  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

përkrahur nga:



British Embassy  
Pristina